



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2024:048566

Datë: 24.12.2024

Numri i dokumentit: 06644571

PAKR.nr.673/2024

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti i Krimeve të Rënda, në kolegjin penal të përbërë nga gjyqtarët, Xhevdet Abazi, kryetar, Afërdita Bytyçi dhe Skender Çoçaj, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Fitore Batatina, në çështjen penale ndaj të akuzuarit A.I nga Vushtrria, Rr. “Boletini”, pa numër, për shkak të veprës penale, Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.2, lidhur me par.1 të KPRK-së, duke vendosur në lidhje me ankesën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Krimeve të Rënda, të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Krimeve të Rënda, PKR.nr.11/2024, i datës 30.09.2024, në seancën e kolegjit me datë 19.12.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Krimeve të Rënda, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Krimeve të Rënda, PKR.nr.11/2024, të datës 30.09.2024, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktgjykimin, PKR.nr.11/2024, të datës 30.09.2024, duke vepruar konform nenit 363 par.1, pika 1.3 të KPK-

së, të akuzuarin A.I e ka liruar nga akuzua për veprën penale, Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.2, lidhur me par.1 të KPRK-së.

Pala e dëmtuar, Drejtoria e Pyjeve në Komunën e Mitrovicës, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Shpenzimet e procedurës penale kanë renë në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Kundër këtij aktgjykimi ka parashtruar ankesë Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Krimeve të Rënda, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 386 të KPPK-së, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Prokuroria e Apelit, më parashtrësën me shkrim, PPA/I.nr.612/2024, të datës 15.11.2024, ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Krimeve të Rënda, të aprovohet si e bazuar, aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Gjykata e Apelit caktoj dhe mbajti seancën e kolegjit në pajtim me dispozitën e nenit 390 të KPPRK-së, në të cilën morën pjesë: përfaqësuesja e palës së dëmtuar, Drejtoria e Pyjeve në Komunën e Mitrovicës, Vlora Gashi Hashani, sipas autorizimit, dhe i akuzuari A.I, ndërsa nuk prezantuan Prokurori i Prokurorisë së Apelit, dhe as mbrojtësi i të akuzuarit, av.Rexhep Kaçaniku, edhe pse të njoftuar në mënyrë të rregullt për kohën dhe vendin e mbajtjes se seancës së kolegjit, andaj, seanca e kolegjit u mbajt konform nenit 390 par. 4 të KPPK-së, në mungesë të tyre. Në seancë përfaqësuesja e palës së dëmtuar, Drejtoria e Pyjeve në Komunën e Mitrovicës, Vlora Gashi Hashani, deklaroi se e përkrah ankesën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë duke propozuar që e njëjta të aprovohet dhe çështja të kthehet në rigjykim. I akuzuari A.I deklaroi se e kundërshton ankesën e Prokurorisë duke i propozuar Gjykatës së Apelit që kjo ankesë të refuzohet ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit pasi që ka studiuar aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Krimeve të Rënda, propozimin e Prokurorisë së Apelit, dhe duke analizuar shkresat e lëndës në këtë çështje penale në vështrim të nenit 394 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale, gjeti se:

*Ankesa nuk është e bazuar.*

*Pretendimet ankimore të Prokurorisë*

Prokuroria në ankesë thekson se arsyet e aktgjykimit ankimor, janë të paqarta dhe kontradiktore me vetveten, me provat dhe dokumentet disponuese në shkresat e lëndës. Më tutje në ankesë prokurori përshkruan provat materiale dhe personale të cilat janë administruar dhe vlerësuar nga gjykata shkallës së parë duke pretenduar se nga keto prova provohet kryerja e veprës penale nga i akuzuari A.I. Sikurse gjykata të kishte marrë për bazë të gjitha këto prova, të arsyetuara si në aktakuzë, prova këto të cilat edhe janë shqyrtuar në shqyrtim gjyqësor, kishte për të nxjerrë një konkluzion krejtësisht tjetër me atë çka ka vendosur në aktgjykimin e atakuar. Nga provat e propozuara në aktakuzë dhe të administruara në shqyrtim gjyqësor pranë gjykatës së shkallës së parë kjo shihet se në veprimet e të akuzuarit A.I qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale si në aktakuzë, të cilat prova gjykata fare nuk u'a ka falur besimin, me çka edhe ka bërë vërtetim të gabuar të gjendjes faktike kur të akuzarin e ka liruar nga aktakuza. Në rastin konkret gjykata nuk ka bërë krahasimin adekuat të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës duke filluar nga Kërkesa për iniciimin e procedurës, provave të tjera që janë të bashkëngjitura në lëndë e deri tek dëshmitë e dëshmitarëve dhënë në prokurori dhe në shqyrtim gjyqësor. Gjykata në rastin konkret nuk i ka trajtuar ato në tërësinë e tyre, nuk ka bërë krahasimin e të gjitha provave të deponuara në gjykatë nga ana e Prokurorisë me ato në shqyrtimin gjyqësor. Në aktgjykimin e atakuar gjykata provave të deponuara nga ana e Prokurorisë nuk u'a ka dhënë besimin. Sikurse gjykata të kishte marrë për bazë edhe provat e propozuara – shqyrtuara të prokurorisë me siguri do të kishte nxjerrë një vendim krejtësisht tjetër. Në mbështetje të arsyrave të cekura në këtë ankesë, ka propozuar që Gjykata Apelit aktgjykimin e ankimuar t'a anuloj dhe lëndën t'ia kthej të njëjtës gjykatë në shqyrtim dhe vendosje të sërishme.

*Gjetjet e Gjykatës së Apelit*

Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë edhe pse me ankesë nuk kundërshtohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi në këtë aspekt – konform dispozitës së nenit 394 të KPPK-së, dhe konstatoi se nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat kishin më kushtëzuar anulimin e tij.

*Pretendimet ankimore për vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe gjetjet e kësaj Gjykate.*

Prokurori e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke pretenduar se gjykata nuk ka vërtetuar në mënyrë të drejtë gjendjen faktike pasi që nga provat e propozuara në aktakuzë dhe të administruara në shqyrtim gjyqësor pranë gjykatës së shkallës së parë kjo shihet se në veprimet e të akuzuarit A.I qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale për të cilën është akuzuar.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit gjen se këto pretendime ankimore të Prokurorit nuk qëndrojnë, ngase nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor nga gjykata e shkallës së parë rezulton se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe se në këtë drejtim asnjë fakt nuk ka ngelur në mëdyshje sikur se pa të drejtë pretendohet në ankesën e ushtruar. Se nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale të përshkruar si në përshkrimin faktik të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar pas administrimit të provave si në vijim: nga deklarimi i dëshmitarëve Safet Doroci, Shefqet Isufi, Ismet Tahiri dhe Ejup Ferati, po ashtu nga provat materiale si: Kërkesa e DQIPGJ nr.323/2023 për iniciimin e procedurës penale, e datës 12.09.2023, Procesverbali i Inspektoratit Qëndror të Pyjeve numër 002526, i datës 21.02.2023, Përgjigjen në procesverbal të Drejtorisë së Mbrojtjes së Mjedisit dhe Pyjeve, Sektori i Pylltarisë, me numër të referencës 14.030/04-0024399/23/2, Vendimi i Drejtorisë së Mbrojtjes së Mjedisit dhe Pyjeve – Sektori i Pylltarisë, i datës 24.03.2023, Procesverbali mbi regjistrimin (revizionin) e terrenit, Raporti i regjistrimit (revizionit) të dëmeve pyjore sipas Nj.K të APK-së për muajin Janar – Qershor 2023, i datës 03.07.2023, Njoftimi nga Drejtori i Drejtoratit Qëndror të Inspektionit për Pylltari dhe Gjueti në Agjencinë Pyjore të Kosovës, i datës 04.04.2023.

Kolegji vlerëson të pa bazuara pretendimet ankimore të Prokurorisë se i akuzuari A.I në pozitën Roje Pylli pranë Drejtorisë për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Pyjeve – Sektori i Pylltarisë – Mitrovicë, përgjegjës për mbrojtjen e territorit pyjor “Maja e zezë” duke shfrytëzuar pozitën apo autoritetin, nuk ka përmbush detyrat zyrtare, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të një dobie pasurore për vete ose tjetrin, e në kundërshtim me ligjin për pyjet nr. 03L-029 dhe udhëzimin administrativ nr. 05/2010 për Mbrojtjen e pyjeve/përgjegjësit dhe obligimet e Rojës së Pyllit, nuk ka arritur t’i arsyetoj dëmet pyjore të shkaktuara nga prerjet ilegale, për muajit janar – qershor 2022, se i ka shkaktuar dëm pyjor të paarsyetuar në sasi prej 35.14m/kub në vlerë monetare prej 5.376.42 euro, Agjencisë Pyjore të Kosovës, në dobi apo favor të personave të pidentifikuar.

Kolegji vëren se në rastin konkret nuk është kontestuese se është shkaktuar dëmi, ashtu siç pretendon prokurori në ankesën e ushtruar, por nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor nuk është vërtetuar se ky dëm është shkaktuar si pasojë e mos përmbushjes së detyrave zyrtare të të akuzuarit A.I me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të një dobie pasurore për vete ose tjetrin, dhe nuk është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit përmbushen elementet e veprës penale, Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, për çka gjykata në mungesë të provave më të drejtë të akuzuarin edhe e ka liruar nga akuza si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Pretendimet e Prokurorit se i akuzuari A.I ka keqpërdorur pozitën apo autoritetin zyrtar, nuk qendojnë, ngase nga dëgjimi i dëshmitarëve të cilët kanë qenë në komisionin për vlerësimin e dëmit, pas administrimit të gjitha provave materiale, si dhe pas dëgjimit edhe të akuzuarit, ky fakt nuk është arritur të vërtetohet me asnjë nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor nga gjykata e shkallës së parë, e që është e domosdoshme të vërtetohet një fakt i tillë për t'u përmbushur elementet e veprës penale për të cilën akuzohet i akuzuari.

Sipas dispozitës ligjore nga neni 414 par.2, lidhur me par.1 të KPRK-së, veprën penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar për të cilën është akuzuar i akuzuari A.I e kryen *“Personi zyrtar, i cili duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar i tejkalon kompetencat e tij ose nuk i përmbush detyrat zyrtare të tij me qëllim që të përfitoj çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër apo që t'i shkaktojë dëm personit tjetër ose që t'i shkel të drejtat e personit tjetër, ...”* Në rastin konkret, i akuzuari sipas aktakuzës akuzohet se në cilësinë e rojës së pyllit ka keqpërdor detyrën zyrtare duke mos i përmbush detyrat e tij zyrtare, me qëllim që të përfitoj çfarëdo dobie pasurore për vete apo personin tjetër, mirëpo siç rezulton nga provat e administruara në shqyrtimet gjyqësor nga gjykata e shkallës së parë, nuk është provuar se i akuzuari ka keqpërdor detyrën zyrtare duke mos i përmbush detyrat e tij zyrtare, me qëllim që të përfitoj çfarëdo dobie pasurore për vete apo personin tjetër, pasi që nga dëshmitaret e dëgjuar në këtë çështje penale që njeherit ishin edhe koleg të të akuzuarit është vërtetuar se i akuzuari edhe përkundër faktit se ka përmbushur detyrat e tij, prapë nuk ka mundur që të mbuloje terrenet të cilat ka pasur t'i mbuloje në cilësinë e rojës së pyllit. Në rastin konkret dhe në rrethanat e tilla në të cilat ka punuar si roje pylli i akuzuari nuk mund të thuhet se nuk ka përmbushur detyrat e tij, pasi që ai sipas kontratës se tij të punës ka pasur 40 orë pune në javë dhe asnjëherë nuk ka pasur vërejte në përmbushjen e orarit të punës, nga ana tjetër i akuzuari vazhdimisht ka kërkuar nga udhëheqësit e tij që të angazhojnë roje pylli shtesë pasi që ai nuk ka mundur që të mbuloje të dy

terenet për shkak të sipërfaqes së tyre të madhe dhe i njëjti nuk e ka fshehur dëmin i cili ishte duke u shkaktuar në ato terene pyjore.

Nga administrimi i provave në shqyrtimet gjyqësore nga gjykata shkallës së parë është vërtetuar fakti se i akuzuari në rastet kur ka hasur në persona duke prerë pyjet ai ndaj tyre ka paraqitur fletëparaqitje, por dëmi i shkaktuar i paarsyetuar për të cilin ai është akuzuar është bërë nga persona të panjohur dhe në këtë drejtim ka munguar edhe qëllimi i përfitimit qoftë për vete qoftë për personin tjetër pasi që i akuzuari nuk e ka ditur se kush kanë qenë personat të cilët kanë dëmtuar pyjet, do të ishte krejt ndryshe nëse i akuzuari gjatë detyrës se tij do të kishte hasur në persona duke prerë pyjet dhe ndaj tyre nuk do të ushtronte fletëparaqitje, mirëpo në rastin konkret nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor nuk është vërtetuar asnjë veprim i të akuzuarit i kësaj natyre.

Nga dëshmia e dëshmitarëve S.D, Sh.I, I. T dhe E.F, rezulton se të njëjtit janë caktuar në komision për vlerësimin e dëmit në rajonin pyjor “Maja e Zezë”, të komunës së Mitrovicës, të cilin teren ka qenë duke e mbuluar si roje pylli i akuzuari A.I, i cili po ashtu ka qenë duke e mbuluar edhe terenin e “Cernushës”. Po ashtu, nga dëgjimi i të njëjtëve rezulton se në rastin konkret dëmi i pa arsyetuar ka qenë 35.14 m<sup>3</sup>, se dëmi i pa arsyetuar është masa drurore e prerë e cila nuk ka mundur të mbulohet nga pyllari me fletëparaqitje, se në rastet kur nuk haset dëmtuesi i pyllit duke e prerë nuk bëhen fletëparaqitje, pra kjo do të thotë se dëmi i paarsyetuar është bërë nga personat e panjohur të cilët pylltari nuk i ka zënë. Nga dëshmitë e këtyre dëshmitareve është vërtetuar se i akuzuari ka qenë i ngarkuar që t’i mbulojë dy rajone pyjore atë të “ Majes se Zeze” dhe atë të “Cernushes”, që janë dy rajone shumë të medhaja që të dyja së bashku janë afërsisht 2500 ha, dhe nëse i akuzuari kishte për të shkuar në vendin e quajtur Cernushë atëherë brenda asaj dite nuk mund ta mbulojë edhe terenin tjetër tek Maja e Zezë, se sipërfaqja e këtyre tereneve e kalon sipërfaqen e lejueshme që duhet ta mbulojë një pylltar. Gjithashtu, nga dëgjimi i dëshmitareve të lartcekur, është vërtetuar se i akuzuari u është drejtuar me shkresë personave përgjegjës duke kërkuar që të lirohet nga njëri teren, me arsyetimin se nuk po mundet që t’i mbulojë të dy terrenet atë të “Cërrnushës” dhe “Majës së Zezë”.

Kolegji vlerëson se gjykata shkallës së parë me të drejtë ka ardhur në përfundim të vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, pasi që nga provat e administruara nuk ka arritur ta vërtetojë dashjen e të akuzuarit, se i njëjti ka shfrytëzuar pozitën e tij dhe ka keqpërdor detyrën

zyrtare duke mos i përmbush detyrat e tij zyrtare, me qëllim që të përfitoj çfarëdo dobie pasurore për vete apo personin tjetër apo qëllimin e shkakimit të dëmit personit tjetër.

Mbi gjendjen faktike të vërtetuar gjykata e shkallës së parë drejtë ka aplikuar edhe ligjin penal, gjithashtu aktgjykimi i kundërshtuar nuk përmban as shkelje tjera të cilat kjo Gjykatë konform dispozitave të nenit 394 të KPPK-së, i vëren çdo herë sipas detyrës zyrtare e të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij. Kolegji është i bindur se gjykata e shkallës së parë ka arritur në përfundimin e arsyeshëm, se nga provat e zbatuara nuk është provuar përtej dyshimit të bazuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, andaj, me të drejtë i akuzuari është liruar nga aktakuza.

Nga arsyet e sipërcekura, e në bazë të nenit 401 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA APELIT E KOSOVËS – Departamenti i Krimeve të rënda  
PAKR.nr.673/2024 me datë 19.12.2024

B.profesionale

Anëtarët e kolegjit:

Kryetar i kolegjit,

Fitore Batatina

Afërdita Bytyçi

Xhevdet Abazi

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Skender Çoçaj

\_\_\_\_\_